- Përcjellë zhvillimin e teknologjisë dhe mundësitë për aplikimin e tyre për nevojat e gjykatave;.....5%.
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatitë raportet javore të punës.....10%.

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit.....E nevojshme;
- Aftësi të operimit me pajisje të teknologjisë informative.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike në harduer dhe aplikacione të ndryshme.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike dhe njohje të sistemeve të audio dhe video incizimit.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: në shkenca kompjuterike.....E nevojshme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune.....E nevojshme;
- Certifikime në MCP, MCSA, MCSE, CCNAdo të kenë përparësi;

Pozita: 20 deri në 44;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar ligjor;

Institucioni: Sekretariati i KGJK-së: - 4 (katër) pozita / **një (1) pozitë e rezervuar për komunitete më pak të përfaqësuar**; Gjykata Supreme: - 1 (një) pozitë; Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme: - 1 (një) pozitë **e rezervuar për komunitete më pak të përfaqësuar**; Gjykata e Apelit: - 1 (një) pozitë; Gjykata Komerciale: - 1 (një) pozitë **e rezervuar për komunitetin serb**; Gjykata Themelore Prishtinë: - 19 (nëntëmbëdhjetë) pozita / **një (1) pozitë e rezervuar për komunitete më pak të përfaqësuar**; Gjykata Themelore Prishtinë – dega Lipjan - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë – dega Graçanicë (komuniteti serb) - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë - 5 (pesë) pozita; Gjykata Themelore Prizren: 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Prizren – dega Suharekë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Gjilan: - 2 (dy) pozita / **një (1) pozitë e rezervuar për komunitete më pak të përfaqësuar**; Gjykata Themelore Gjilan – dega Viti - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Gjilan – dega Kamenicë - 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Ferizaj: 7 (shtatë) pozita; Gjykata Themelore Ferizaj – dega Kaçanik - 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Pejë: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Pejë – dega Klinë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Pejë – dega Istog - 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Gjakovë: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Gjakovë – dega Malishevë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Gjakovë – dega Rahovec - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Mitrovicë: 6 (gjashtë) pozita; Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Vushtri: 1 (një) pozitë dhe Gjykata Themelore Mitrovicë – dega Skenderaj: 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;

Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Klasa J-Grupi J16-Koeficienti 5.3/ (583.00€)

Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë
Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës dhe gjyqtarit me të cilin punon në Gjykatë / gjyqtarit me të cilin punon dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës në degë

Vlerësimi i performancës: nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon/ gjyqtarin me të cilin punon dhe Gjyqtarin Mbikëqyrës në degë

Vendndodhja: Gjykatë /degë përkatëse

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese gjashtë (6) muaj

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas Vendimin KGJK.nr.553/2023 datë 27 dhjetor 2023

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Kryen të gjitha punët që kanë të bëjnë me shërbimet rreth lëndëve dhe administrimit të tyre në SMIL sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Mban procesverbalin gjatë seancave gjyqësore dhe ngarkon procesverbalin e seancës gjyqësore në SMIL, si dhe delegon lëndën tek gjyqtari për marrjen e vendimit;.....20%
- Kryen të gjitha veprimet e kërkuara me sistem për të ftuar palët në seancën gjyqësore dhe cakton orarin për mbajtjen e seancës gjyqësore sipas udhëzimeve të gjyqtarit;.....20%
- Për rastet kur kërkohet të bëhet shpërndarja urgjente e shkresave të lëndës, përgatite shkresat dhe kryen veprimet me SMIL për shpërndarje, dorëzim dhe pranim të rezultatit të shpërndarjes;.....10%
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;.....10%
- Përgjegjës për udhëheqjen e punëve të sekretarisë dhe për ofrim të punës cilësore;.....10 %
- Shtyp të gjitha vendimet dhe shkresat tjera të gjykatës, përgatitë dhe organizon protokollin nga seancat;.....10%
- Kryen veprime të tjera në SMIL, varësisht nga detyrat e deleguara nga gjyqtari përkatës, si dhe veprimet e tjera të përcaktuara me rregulloret të cilat janë në zbatim;.....10 %
- Kryen edhe detyra tjetër në sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatitë raportet javore të punës.....10%

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit.....E nevojshme;
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore.....E nevojshme;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti juridik.....E nevojshme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune.....E nevojshme;

Pozita: 45;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar i Pasurisë;

Institucioni: Sekretariati i KGJK-së: - 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;

Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Klasa J-Grupi J16-Koeficienti 5.3/ (583.00€)

Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Departamenti për Buxhet dhe Financa

Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Divizionit për të Hyra dhe Pasuri

Vlerësimi i performancës: Behet nga Udhëheqësi i Divizionit për të Hyra dhe Pasuri në koordinim me Drejtorin e Departamentit për Buxhet dhe Financa

Vendndodhja: Sekretariati i KGJK-së

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese gjashtë (6) muaj

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas Vendimin KGJK.nr.553/2023 datë 27 dhjetor 2023

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Regjistrimi i pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale në SIMFK (mbi 1,000.00 €) dhe në sistemin “e-pasuria” apo ndonjë sistemi alternativ (nën 1,000.00 €) si dhe mbajtja e evidencës dhe krijimi i regjistrimit të pasurisë jo financiare për të gjitha gjykatat dhe njësitë e Këshillit. Me këtë pozitë synohet të arrihet realizimi i objektivave të Departamentit për Buxhet dhe Financa dhe Institucionit duke zbatuar rregullativën ligjore në fuqi për çështje të pasurisë jo financiare.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Nën mbikëqyerjen e udhëheqësit të divizionit regjistron pasurinë jo financiare kapitale të Këshillit në SIMFK (mbi 1,000.00 €);.....20%
- Regjistron pasurinë jo financiare jo kapitale të Këshillit dhe krijon regjistrin e pasurisë jo financiare në sistemin “e-pasuria” apo ndonjë sistem alternativ (nën 1,000.00 €);.....20%
- Përditëson regjistrin e pasurisë jo financiare të Këshillit në SIMFK (mbi 1,000.00 €);.....10%
- Përditëson regjistrin e pasurisë jo financiare të Këshillit në sistemin “e-pasuria” apo ndonjë sistem alternativ (nën 1,000.00 €);.....10%
- Mban evidencë elektronike dhe fizike për të gjithë pasurinë jo financiare të gjykatave dhe njësitë të Këshillit në bazë të raporteve periodike nga gjykatat dhe njësitë e Këshillit;.....10%
- Kontakton dhe bashkëpunon me gjykata për t'i ndihmuar dhe mbështetur lidhur me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë jo financiare të gjykatave;.....10%
- Përgatit raportet të ndryshme lidhur me pasurinë jo financiare kapitale dhe jo kapitale të gjykatave dhe njësitë të Këshillit sipas nevojës si dhe merr pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara nga Këshilli apo institucione tjera në lidhje me buxhetin dhe financat publike dhe ndërlidhet me MFPT dhe institucione tjera qeveritare dhe ndër-qeveritare;.....10%
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të miratuara nga Këshilli, të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi;.....10%

Niveli i përgjegjësishë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- **Regjistrimi, përditësimi dhe raportimi i pasurisë jo financiare të gjykatave dhe njësive të Këshillit.**

Shkathtësitë e kërkua: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Aftësi të organizoj, drejtoj dhe koordinoj programet financiare dhe të buxhetit.....E nevojshme;
- Aftësi për njohje dhe përdorim të software dhe programeve kompjuterike.....E preferueshme;
- Njohja e gjuhëve zyrtare të aplikueshme në Kosovë dhe gjuhës angleze.....E preferueshme;
- Certifikatë për vijimin e trajnimeve profesionale dhe arsimore.....E preferueshme;
- Aftësi të dëshmuara në përcjelljen e procedurave të reja financiare dhe implementimin e tyre në praktikë.....E nevojshme;
- Shkathtësi të dëshmuara në komunikim dhe në ofrimin e shërbimeve për nevoja të institucioneve gjyqësore.....E preferueshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: në drejtimin ekonomik, biznes apo të gjashmeE nevojshme;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në administrim të buxhetit dhe financave apo të ngjashmeE nevojshme;

Pozita: 46;

Titulli i pozitës së punës: **Zyrtar për Buxhet dhe Financa;**

Institucioni: Sekretariati i KGJK-së: - 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;

Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Klasa J-Grupi J16-Koeficienti 5.3/ (583.00€)

Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Departamenti për Buxhet dhe Financa

Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa

Vlerësimi i performancës: bëhet nga Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa në koordinim me Drejtorin e Departamentit për Buxhet dhe Financa

Vendndodhja: Sekretariati i KGJK-së

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese gjashtë (6) muaj

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas Vendimin KGJK.nr.553/2023 datë 27 dhjetor 2023

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Të ndihmoj udhëheqësin e divizionit për Buxhet dhe Financa dhe drejtorin e departamentit për Buxhet dhe Financa në planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit për të gjitha programet buxhetore të Këshillit, të pranoj dhe procesoj kërkesat e ndryshme nga departamentet dhe njësitë tjera të Këshillit përkatësisht Sekretariatit për të gjitha llojet e shpenzimeve si dhe të mbaj evidencë analitike dhe sintetike për këto shpenzime, të përgatit, procesoj dhe kontrolloj parat e imëta (Petty cash) për Sekretariatit, si dhe hapjen dhe rimbushjen e parave të imta për gjykata.

Me këtë pozitë synohet të arrihet realizimi i objektivave të departamentit për Buxhet dhe Financa si dhe institucionit duke zbatuar legjislacionin në fuqi për çështje buxhetore dhe financiare.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të divizionit proceson, bënë zotimin e të gjitha kërkesave për pagesa nga njësitë e Këshillit si dhe të regjistrojnë të gjitha shpenzimet në sistemin e evidencës kontabël në Sekretariat;.....20%
- Pranon, proceson dhe kontrollon kërkesat për hapjen, rimbushjet dhe mbylljen e parave të imëta (petty cash) për Këshillit dhe avanset për udhëtime zyrtare për Këshillin dhe gjykatat;.....20%
- Përgatit raportet e nevojshme për të gjitha pagesat e procesuara të Këshillit;.....20%

- Ndhimmon shefin e divizionit dhe drejtorin e Departamentit për Buxhet dhe Financa në planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit për gjykatat dhe njësitë tjera të Këshillit;.....10%
- Bën tërheqjen dhe shpërndarjen e avanceve për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit si dhe kthimin e mjeteve në bankë për mbylljen e parave të imëta dhe avanceve për udhëtime zyrtare si dhe bënë barazimin e shpenzimeve komunale, ATK dhe trustit pensional;.....10%
- Merr pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara nga Këshilli apo institucione tjera në lidhje me buxhetin dhe financat publike që ndërlidhet me MF dhe institucione tjera qeveritare dhe ndërqeveritare;.....10%
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të miratuara nga Këshilli, të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyri;.....10%

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- **Procesimi, monitorimi dhe raportimi i buxhetit dhe shpenzimeve të Këshillit dhe njërive të Këshillit.**

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Aftësi të organizoj, drejtoj dhe koordinoj programet financiare dhe të buxhetit.....E nevojshme;
- Aftësi për njohje dhe përdorim të software dhe programeve kompjuterike.....E preferueshme;
- Njohja e gjuhëve zyrtare të aplikueshme në Kosovë dhe gjuhës angleze.....E preferueshme;
- Crtifikatë për vijimin e trajnimeve profesionale dhe arsimore.....E preferueshme;
- Aftësi të dëshmuara në përcjelljen e procedurave të reja financiare dhe implementimin e tyre në praktikë.....E nevojshme;
- Shkathtësi të dëshmuara në komunikim dhe në ofrimin e shërbimeve për nevoja të institucioneve gjyqësore.....E preferueshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: në drejtimin ekonomik, biznes apo të gjashtëE nevojshme;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në administrim të buxhetit dhe financave apo të ngjashmeE nevojshme;

Pozita: 47, 48, 49 dhe 50;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për të hyra;

Institucioni: Gjykata Komerciale: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Mitrovicë: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Gjakovë – dega Malishevë - 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;

Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Klasa J-Grupi J16-Koeficienti 5.3/ (583.00€)

Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Buxhet dhe Financa në Gjykatë/ zyra e Ndhimës administratorit në degë

Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Gjykatë/ Ndhimës administratorit në degë

Vlerësimi i performancës: Nga Udhëheqësi i Zyrës për Buxhet dhe Financa në Gjykatë/ Ndhimës administratori në degë

Vendndodhja: Gjykatë / degë

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese gjashtë (6) muaj

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas Vendimin KGJK.nr.553/2023 datë 27 dhjetor 2023

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Zyrtari për të hyra-arkëtari është zyrtari për arkëtimin e të hyrave dhe depozitave gjyqësore të cilat pranohen në gjykatë/degë dhe procesohen nëpërmjet Sistemit Elektronik për Menaxhimin e të Hyrave (SEMH) dhe sistemeve tjera elektronike nga MFPT dhe sisteme tjera si “E-Kosova”. Zyrtari për të hyra-arkëtari i degës së gjykatës themelore është edhe kujdestar i fondit të parave të imëta (petty cash) në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të miratuara nga Këshilli.

Me këtë pozitë synohet të arrihet realizimi i objektivave të Zyrës për Buxhet dhe Financa dhe gjykatës duke zbatuar legjislacionin në fuqi për çështje të hyrave, buxhetit dhe financave.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Plotëson dhe lëshon Urdhërpagesa për palët nga Sistemi elektronik për menaxhimin e të hyrave (SEMH) për të hyra dhe depozita si dhe në sisteme tjera elektronike nga MFPT dhe sisteme tjera si “E-Kosova” në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;.....25%
- Konfirmon pagesat në SEMH dhe pranon kopjet e pagesës nga palët si dhe i arkivon urdhërpagesat;.....20%
- Pranon dhe regjistron pagesat nën 5 euro në SEMH dhe bën zbrazjen e arkës si dhe deponon mjetet në bankë për këto zbrazje sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;15%
- Bënë barazime mujore të pagesave të konfirmuara të Gjykatës/degës në SEMH me pagesat e barazuara nga zyrtari për barazime në Gjykatë Themelore. Zyrtari për të hyra-arkëtari tek Gjykata Supreme/Dhoma e Posaçme bëjnë barazime mujore të pagesave të konfirmuara të gjykatës me pagesat e barazuara nga zyrtari për barazim në Gjykatën Supreme;.....10%
- Ruan një kopje të nënshkruar nga ai, administratori /ndihmës administratori dhe zyrtari për barazime i gjykatës të raporteve mujore të barazimeve për qëllime raportimi dhe auditimi. Si kujdestar i fondit të parave të imëta (petty cash), zyrtari për të hyra –arkëtari i degës së gjykatës themelore proceson dhe kontrollon kërkesat për hapjen dhe rimbushjet e parave të imëta (petty cash) për degën e Gjykatës Themelore;.....10%
- Siguron kontroll të brendshëm, zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve në kohë dhe me kosto efektive;.....10%
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatitë raportet javore të punës;10%

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- Sipas legjislacionit në fuqi

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave.....E nevojshme;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese të informacionit.....E nevojshme;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit.....E nevojshme;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës.....E nevojshme;
- Fleksibilitet ndaj organizimit, mbikëqyrjes së punës dhe zgjidhjes së problemeve.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: drejtimi ekonomik, financa apo biznes.....E nevojshme;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune.....E nevojshme;

NJOFTIM PËR KANDIDATËT

- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në administratën e sistemit gjyqësor, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtar Publik;
- Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara, siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë përfshirë edhe ato të dorëzuara me postë nuk pranohen, dhe aplikacionet e pa kompletuara refuzohen.
- **Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe i lexueshëm;**
- Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim bëhet brenda **TRIDHJETË (30) ditëve** nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit;
- **KOMUNIKIMI** me kandidatët që kanë konkuruar, në çdo fazë të procesit, bëhet vetëm përmes njoftimeve të shpallura në **UEB faqen zyrtare të Këshillit**

- **FORMULARI I APLIKIMIT** - formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

- [Shkarko Aplikacionin](#)

- **AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE** Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga publikimi i konkursit, Sekretariatit e KGJK-së, Rruga “Luan Haradinaj” nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimi.

- Data e fillimit të aplikimi: **3 MAJ 2024**
- Data e fundit të aplikimit: **01 QERSHOR 2024**

Kriteret e përgjithshme për pranim

1. Kriteret e përgjithshme që një kandidat duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar në administratën e sistemit gjyqësor, në cilëndo kategori apo nivel të paraparë, janë:
 - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore (**kërkohet vetëm për kandidatët që shpallen fitues**);
 - 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; (**kërkohet vetëm për kandidatët që shpallen fitues**);
 - 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
 - 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
 - 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë rregullore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Aplikacioni për rekrutim në administratën e sistemit gjyqësor përmban të dhënat si më poshtë:
 - 1.1. referencën e shpalljes së procedurës së rekrutimit;
 - 1.2. titullin e vendit të punës dhe institucionin;

1.3. të dhënat personale të kandidatit

1.4. nivelin e arsimimit, si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit;

1.5. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë të dhëna si:

1.5.1. emrin e punëdhënësit;

1.5.2. titullin, gradën dhe/apo të ngjashme;

1.5.3. kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;

1.5.4. përshkrimin e detyrave kryesore të punës;

1.5.5. numrin dhe llojin e personelit nën mbikëqyrje, nëse ka;

1.5.6. adresën dhe kontaktin e punëdhënësit paraprak;

1.5.7. arsyet për përfundimin e marrëdhënies/eve paraprake të punës.

1.6. njohuritë gjuhësore;

1.7. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera apo të ofruara, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet nëse kërkohen në konkurs;

1.8. njohuritë kompjuterike.

2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim:

2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë

2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit;

2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;

2.4. kopjen e dëshmisë së vlerësimit të performancës së punës në tre vitet e fundit, nëse ka.

2.5 kopja e letërnjoftimit apo dokument identifikimi

3. Kopja e dëshmisë se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore dhe dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje, dorëzohen gjatë fazës së verifikimit para emërimit.

4. Kandidatët e plotësojnë aplikacionin në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve.

5. Aplikacioni për aplikim për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor: Shtojca nr.1 – FORMULARI: Aplikacion punësimi/kërkesa për punësim.

Procedura e pranimit

1. Procedura e pranimit për të gjitha kategoritë e të punësuarëve në administratën e sistemit gjyqësor fillon me konkurrim, i cili zhvillohet në dy (2) faza:

1.1. verifikimi paraprak përmes të cilit nga ana e NjMBNj verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe

1.2. vlerësimi profesional përmes të cilit Komisioni i pranimit bënë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve përmes testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

2. Në procedurën e vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim kandidati mund të vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë, ndërsa testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testin me shkrim.

3. Në procedurën e vlerësimi nëpërmjet intervistën me gojë kandidati mund të vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë.

4. Në procedurën e vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim dhe me gojë kandidati mund të vlerësohet deri në njëqind (100) pikë ndërsa kandidati i rekomanduar për pranim duhet të fitojë jo më pak se shtatëdhjetë (70) pike.

